



REPUBLIKA E KOSOVËS
KOMUNA LIPJAN
REPUBLIKA KOSOVO
OPŠTINA LIPLJAN

Prenuar më: 24-02 20 20		
Priljena:		
Njesia Jedritica	Numri Broj	Shtojca Dodatak
1-116-	11369	



REPUBLIKA E KOSOVËS
REPUBLIKA KOSOVA
REPUBLIC OF KOSOVA

KOMUNA E LIPJANIT
OPŠTINA LIPLJAN
MUNICIPALITY OF LIPJAN

MEMORANDUMIN PËR MIRËKUPTIM

NE MES

KOMUNËS SË LIPJANIT, SHOQATES SE PENSIONISTËVE DHE ROMACTED PROGRAMIT-Grupit Veprues të Komunitetit

Palët e këtij Memorandumi të Mirëkuptimit janë:

1. KOMUNA E LIPJANIT, me adresë: rruga Shqipëria të cilën e përfaqëson, Nënkryetari i Komunës z.Lulzim Qerimi .
2. SHOQATA E PENSIONISTVË-NËNDEGA NË JANJEVË, me adresë: Janjevë
3. RAMACTED -GRUPI VEPRUES I KOMUNITETEVE (GVK), me adresë në Janjevë

Neni 1

Qëllimi i Momerandumit për Mirëkuptim

Qëllimi i këtij Memorandumi për mirkuptim është të krijoj një bashkëpunim të ngushtë dhe efektiv midis Komunës së Lipjanit, Shoqatës së Pensionistëve dhe Klubit Rinor Janjevë për relizimin e projektit të përbashkët me qëllim të funksionalizimit dhe hapjes së Qendrës Rinore në Janjevë duke iu referuar projektit të përbashkët të Bashkimit

Evropian / Këshillit të Evropës - Programit ROMACTED: "Promovimi i qeverisjes së mirë dhe fuqizimi i romëve në nivelin lokal", me qëllim të realizimit të një projekti për komunitetet " KLUBI RINOR NE JANJEVË ".

Projekti është bashkëfinancuar nga Këshilli i Evropës, d.m.th., Programi ROMACTED për Komunën e Lipjanit, bazuar në marrëveshjen e grantit të datës 12.11.2019, e cila zbatohet për një periudhë prej 6 muajsh. Zbatimi i projektit fillon më 12 nëntor 2019, dhe mbaron më 11. maj 2020.

Neni 2

OBLIGIMET E PALËVE NËNSHKRUESE TË MEMORANDUMIT

1. Komuna e Lipjanit në bashkëfinancim me Këshillin e Evropës do të investojnë në objektin-ndërtesën në sipërfaqe prej 124 m², e cila gjendet në njësinë kadastrale P-71409033-00686-0, Zona kadastrale Janjevë, pronë shoqërore, me adresë të njësisë kadastrale klubi penzionera, pasuri shoqërore e shoqatës së penzionerëve.
2. Kati i dytë i objektit do të shfrytëzohet në afat të pacaktuar nga të rinjtë e Janjevës mirëpo pronësia e objektit do të mbetet e Shoqatës së pensionistëve të Janjevës.
3. Menaxheri i objektit do të jetë Shoqata e pensionistëve e cila në vazhdim do të njoftohet për zhvillimet e Klubit rinor si dhe për planin kohor të zhvillimit të aktiviteteve.
4. Klubi rinor do të mbulojë shpenzimet komunalë për hapësirën të cilën e shfrytëzon si dhe do të jetë nën mbikqyrjen e Drejtoratit për Kulturë, Rini dhe Sport.
5. **Përgjegjësitë e Komunës Lipjan**
 - a) Komuna do të realizoj veprimet financiare dhe teknike sipas marrëveshjes që e obligon në kuader të projektit të përbashkët.
 - b) Menaxheri I percaktuar I projektit nga ana e Komunës do të ketë bashkëpunim dhe koordinim periodik me GVK të parapar sipas projektit.
 - c) Komuna do të kontriboj në fuqizimin e klubit/qendrës rinore

Lipjan, edhe pas perfundimit të keti projekti përmes drejtoris përkatëse (Drejtoratit për Kulturë, Rini dhe Sport).

6. Përgjegjësite e Grupit të Veprimit të Komunitetit ROMACTED janë si vijon:

- d) Avokimi i të gjithë anëtarëve për zbatimin e qetë dhe efikas të projektit,
- e) b) Emërimi i një anëtari të CAG
- f) Anëtari i CAG do të jetë pjesë e monitorimit të zbatimit të projektit së bashku me anëtarin e GUP,
- g) Një anëtar i CAG do të marrë pjesë në takime të rregullta dhe do të bashkëpunojë ngushtë me Menaxherin e Projektit

Neni 3

Zgjidhja e Mosmarrëveshjeve mes palëve nënshkruese të Memorandumit

1. Secila mosmarrëveshje, kundërshtim ose pretendim që del nga dhe në lidhje me këtë Memorandum Mirëkuptimi do të zgjidhet miqësisht nga negociatat midis palëve.
2. Ky Memorandum mund të ndryshohet , plotësohet ose shkëputet me vullnetin e palëve kontraktuese.
3. Secila mosmarrëveshje, ose kundërshtim midis palëve që lindin nga ky Memorandum Mirëkuptimi që nuk është zgjidhur miqësisht në përputhje me paragrafin e parë të këtij neni, do të zgjidhet nga gjykata kompetente në përputhje me ligjet në fuqi të Kosovës.

Neni 4

Hyrja në fuqi dhe nënshkrimi i Memorandumit nga palët

Memorandumi i Mirëkuptimit hyn në fuqi ditën e nënshkrimit nga palët e cekura më lartë.

Memorandumi u nënshkrua nga Komuna e Lipjanit ,Shoqata e Pensionistëve dhe ROMACTED-Grupet e Veprimit për Komunitete në tri origjinale në gjuhën shqipe, nga një për secilën palë.

Për dhe në emër të komunës së Lipjanit



Data: 21.02.2020

Për dhe në emër të Shoqatës së

Pensionistëve



Data: 21.02.2020

Për dhe në emër të ROMACTED

Grupit të veprimit për Komunitete

FERIAT GASI

Data: 21 0 220

[Signature]